



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 373/2 prot.,

Datë 22.02.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SORI-AL” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-48995-11-07-2022, me objekt: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi*”, për Forcat e Armatosura, ndarë në 4 (katër) Lote”, me fond limit 154,786,352 lekë pa TVSH, Loti I me Nr. REF-48998-11-07-2022, me objekt: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 5001 (AFA) Tiranë*”, me fond limit të lotit 94,856,552 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 14.02.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Ankimues:

“SORI-AL” SHPK

Adresa: Rruga “Faik Konica”, Pallati “Golden Park Residencë” H.1, K.1, Z.1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara

Adresa: Blv “Dëshmorët e Kombit” Nd.1, 1001, Tiranë.

Në datën 22.02.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 373 prot., e operatorit ekonomik “SORI-AL” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-48995-11-07-2022, me objekt: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi*”, për Forcat e Armatosura, ndarë në 4 (katër) Lote”, me fond limit 154,786,352 lekë pa TVSH, Loti I me Nr. REF-48998-11-07-2022, me objekt: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 5001 (AFA) Tiranë*”, me fond limit të lotit 94,856,552 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 14.02.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “SORI-AL” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “SORI-AL” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 373 prot., datë 22.02.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

- *Ofertuesi nuk plotëson pikën 5, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nga verifikimet e kryera, ka rezultuar se ky OE ka deklaruar ne stafin e tij per zbatimin e kontrates objekt prokurimi, punonjes te cilet aktualisht i ka te angazhuar prane Akademise se Sigurise sipas kontrates me objekt prokurimi: “Sherbimi gatimi dhe shperndarje ushqimi per Akademmine e Sigurise” te zhvilluar ne date 03.08.2022, dhe konkretisht punonjesit: D.B., K.B dhe Dh.S.. Bazuar ne shenimin 2.4, pika 5 seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Staf i cili do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor, per zbatimin e kesaj kontrate, nuk duhet te jete i angazhuar ne kontrata te tjera, deri ne perfundim te kontrates. Bazuar ne paragrafin e fundit te Shtojces 8 te DST, “Rastet e mosparaqitjes se nje dokumenti, ose dokumente false dhe te pasakta, konsiderohen kushte per skualifikim.”.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 22.02.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri